

**SEKTORI  
INSPEKTIM-MONITORIMIT  
USSH**

**BAZA LIGJORE E FUNKSIONIMIT TE  
KETIJ SEKTORI**

- Ky sektor eshte ngritu me Vendim te Keshillit Kombetar te USSH me date 18.01.2016 me Nr.Vendimi 02.
- Ky vendim eshte I mbeshtetur ne ligjin 127/2014 dhe gjen perkrahje nga nenet 1-7, me konkret eshte neni 4/2.b I cili thote "vendos standarte etike dhe deontologjike, te detyrueshme per cdo stomatolog dhe monitoron zbatimin e tyre gjate ushtrimit te profesionit"; si dhe neni 7.2. "Urdhri i Stomatologut bashkëpunon me Inspektoratin Shtetëror Shëndetësor për kontrollin e zbatimit të këtij ligji dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fushën e shëndetësisë".

## SEKTORI INSPEKTIM-MONITORIMIT

- Mbeshtet veprimtarine e tij ne monitorimin dhe zbatimit te te gjitha akteve ligjore dhe rregullative qe burojne nga USSH.
- Gjithashtu ne rastet kur hasen dhe konstatohen shkeljet ligjore te sherbimit shendetesor ne Republikën e Shqiperise, ato do referohen te instancat perkatese per te ndermar masat perkatese.

## LEGJISLACIONI USSH

Sektori jone ka detyrim te drejtperdrejte per te monitoruar zbatueshmerine e :

1. Ligjit 127/2014 dt 02.10.2014
2. Statutit ( vendim KK nr 13, dt.31.7.2015)
3. Kodit te etikes( vendim KK nr 3, dt.14.4.2015)
4. Rregulloren e praktikes profesionale (vendim KK nr 24, dt.02.11.2015)

## Ligjit 127/2014 dt 02.10.2014

- Per sa l perket ligjit fokusohemi te nenet 3,4,5,6,15, 16 & 20.Rendesi te vecante ne zbatueshmerine e tij paraqet :
- Neni 4.2.c “Për të përmbushur misionin e tij, Urdhri i Stomatologëve ushtron këto kompetenca: c) rivlerëson periodikisht kompetencën dhe performancën profesionale të anëtarit të Urdhrit të Stomatologëve përballë standardeve të vendosura”
- Neni 5.1.ç”
  1. Janë anëtarë të Urdhrit të Stomatologut të gjithë stomatologët që ushtrojnë profesionin e stomatologut në Republikën e Shqipërisë dhe përmbushin kriteret e mëposhtme:
    - ç) të njohin dhe të zotohen me shkrim që do të zbatojnë kërkesat e legjislacionit në fuqi, statutin dhe Kodin Etik dhe Deontologjik Stomatologjik” dhe neni 5.4.c
    - 4.“Ndhmësstomatologët regjistrohen në një regjistër të veçantë të Urdhrit. Ndhmësstomatologu për t’u regjistruar në Urdhriin e Stomatologut duhet të plotësojë këto kriteret:
      - c) të njohë dhe të zotohet me shkrim që do të zbatojë kërkesat e legjislacionit në fuqi, statutin dhe Kodin Etik Deontologjik Stomatologjik.

## Ligjit 127/2014 dt 02.10.2014

- Neni 6 Detyrimet e anëtarëve të Urdhrit
  1. **Asnjë individ nuk mund të ushtrojë profesionin e stomatologut** dhe të ndihmësstomatologut në sistemin e kujdesit shëndetësor, publik apo privat, në Republikën e Shqipërisë, **pa qenë anëtar i Urdhrit** të Stomatologut dhe pa qenë i pajisur me licencën për ushtrimin individual të profesionit, të lëshuar nga ky organizëm.
  2. Anëtari i Urdhrit ka këto detyrime:
    - a) të ushtrojë profesionin dhe të ketë sjellje profesionale në përshtatje me kërkesat dhe standardet e legjislacionit shqiptar në fushën e shëndetësisë, Statutin e Urdhrit të Stomatologut dhe Kodin Etik Deontologjik Stomatologjik.
    - b) të punojë pa ndërprerje për rritjen e standardeve profesionale dhe të cilësisë së kujdesit shëndetësor në institucionin ku punon **dhe të marrë pjesë rregullisht në programet e edukimit në vazhdim mjekësor. Me kete nen dhe per zbatimin e ketij ne mbeshtetemi per te kerkuar [mosushtrimin e profesionit per mosplotesim kreditesh.](#)**
    - c) **të paguajë rregullisht kuotizacionet e anëtarësisë**, tarifat e regjistrimit, të dhënies së të drejtës së ushtrimit të profesionit dhe shërbime të tjera administrative në përputhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore, në zbatim të tij. **Me kete nen dhe per zbatimin e ketij ne mbeshtetemi per te kerkuar [logaridhenje reth kuotave vjetore.](#)**

## Statutit ( vendim KK nr 13, dt.31.7.2015)

- Per sa l perket statutit fokusohemi te nenet 1,2,3,4,5,6,7,14,15,16,19,36,37,39,40,41 & 42.
- Rendesit te vecante ne zbatueshmerine e tij paraqet :
- Neni 4.2.b,c,f,  
Neni 4 Misioni dhe funksionet e Urdhrit
- 2)Për te përmbushur misionin e tij, ussh ushtron keto kopetenca:
  - b. **vendos standarde etike dhe deontologjike, të detyrueshme për çdo stomatolog dhe monitoron zbatimin e tyre gjatë ushtrimit të profesionit;**
  - c. **rivlerëson periodikisht kompetencën** dhe performancën profesionale të anëtarit të Urdhrit të Stomatologëve përballë standardeve të vendosura;
  - f. **krijon dhe mban Regjistrin Themeltar të Urdhrit**, i cili është i ndarë në pjesë të veçanta për stomatologët dhe ndihmësstomatologët dhe **menaxhon sistemin e administrimit dhe përditësimit të tij;**  
**Me kete nen dhe per zbatimin e ketij, ne mbeshetemi per te kerkuar informacione per mjekun dhe adresen e klinikes, si dhe formalizojme sektorin stomatologjik.**
- Neni 5.1.d dhe 5.3.c  
Neni 5 Kriteret e anëtarësisë
  - 1. Janë anëtarë të Urdhrit të Stomatologut të gjithë stomatologët që ushtrjnë profesionin e stomatologut në Republikën e Shqipërisë dhe përmbushin kriteret e mëposhtme:
    - d) të njohin dhe të zotohen me shkrim që do të zbatojnë kërkesat e legjislacionit në fuqi, statutin dhe Kodin Etik dhe Deontologjik Stomatologjik.
- 5.3.c  
3. Ndhmësstomatologët regjistrohen në një regjistër të veçantë të Urdhrit.
  - c) të njohë dhe të zotohet me shkrim që do të zbatojë kërkesat e legjislacionit në fuqi, statutin dhe Kodin Etik Deontologjik Stomatologjik.

## Statutit ( vazhdim)

- Neni 6 (ne teresi) ,  
Neni 6 Detyrimet e anëtarëve të Urdhrit
  - 1. **Asnjë individ nuk mund të ushtrjë profesionin e stomatologut dhe të ndihmësstomatologut** në sistemin e kujdesit shëndetësor, publik apo privat, në Republikën e Shqipërisë, **pa qenë anëtar i Urdhrit** të Stomatologut dhe pa qenë i pajisur me licencën për ushtrimin individual të profesionit, të lëshuar nga ky organizëm.
  - 2. Anëtar i Urdhrit ka këto detyrime:
    - a) të ushtrjë profesionin dhe të ketë sjellje profesionale në përshtatje me kërkesat dhe standardet e legjislacionit shqiptar në fushën e shëndetësisë, Statutin e Urdhrit të Stomatologut dhe Kodin Etik Deontologjik Stomatologjik.
    - b) **të punojë pa ndërprerje për rritjen e standardeve** profesionale dhe të cilësisë së kujdesitshëndetësor në institucionin ku punon dhe **të marrë pjesë rregullisht** në programet e **edukimit në vazhdim** mjekësor.
    - c) **të paguajë rregullisht kuotizacionet** e anëtarësisë, tarifat e regjistrimit, të dhënies së të drejtës së ushtrimit të profesionit dhe shërbime të tjera administrative në përputhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore, në zbatim të tij.

## Statutit ( vazhdim)

- Neni 7.2,  
Neni 7 Bashkëpunimi  
2. Urdhri i Stomatologut bashkëpunon me Inspektoratin Shtetëror Shëndetësor për kontrollin e zbatimit të këtij ligji dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fushën e shëndetësisë.
- Neni 19.2,3,5,  
Neni 19 Aparati Qendror i Këshillit Kombëtar  
2. Organizon dhe mbikëqyr procesin e regjistrimit, anëtarësimit dhe administrimit të Regjistrit të Stomatologëve në nivel kombëtar e rajonal;  
3. Mbikëqyr veprimtarinë për pajisjen e stomatologëve me Liçensën për ushtrimin individual të profesionit dhe përcakton kriteret për lëshimin e saj;  
5. Drejton dhe mbikëqyr sistematikisht veprimtarinë e Këshillave Rajonalë;
- Neni 42 Kuotizacionet  
1) **Kuotizacioni mujor për anëtarët është i detyrueshëm.** Masa e kuotizacionit përcaktohet me vendim të Këshillit Kombëtar.  
2) Kur për një periudhë prej më shumë se një vit kalendarik, nuk shlyen kuotizacionet dhe nuk paraqitet arsye e justifikueshme, anëtarit i pezullohet anëtarësimi në USSH dhe Liçensa për ushtrimin individual të profesionit.
- Me kete nen dhe per zbatimin e ketij ne mbeshtetemi per te kerkuar [pezullimin e licenses dhe e delegoime te KR per gjykim disiplinor.](#)

## Kodit te etikes (vendim KK nr 3, dt.14.4.2015)

- Per sa I perket statutit fokusohemi te nenet:  
1,2, 4,9,11,13,22,28,34,35, 36,42,45,46, 57,59, 60,  
61,63,65,67 & 68.
- Rendesiti te vecante ne zbatueshmerine e tij paraqet  
neni 1;2;9; 34; 35;45; 57; 59;60;63; 65;66;67& 68.

**Rendesi te vecante ne zbatueshmerine e tij paraqesin nenet**

- Neni 1 - Përcaktimi  
Deontologjisë Stomatologe është një bashkësi principesh dhe rregullash të cilat Mjeku Stomatolog dhe ndihmës Stomatolog(1) është i detyruar t'i njohë dhe t'i respektojë gjatë ushtrimit të profesionit. Sjellja e mjekut, edhe jashtë ushtrimit të profesionit, duhet të jetë shembullore në përputhje me dinjitetin që kërkon ky profesion. Mjekët janë të detyruar të njohin principet dhe rregullat që përmbahen në këtë Kod dhe në bazë të tyre, të përshtasin sjelljen profesionale.
- Neni 2 Njohja e Ligjit të Urdhrit Stomatologut  
Çdo Stomatolog e ka detyrë të njohë Ligjin 127, datë 02.10.2014 "Për Urdhrin e Stomatologut në Republikën e Shqipërisë", Urdhri I Stomatologut si një ent public jo buxhetor dhe autoritet i vetrregullimit profesional të pavarur, si dhe legjislacionin në fushën e shëndetësisë dhe sigurimeve të kujdesit shëndetësor.
- 45 Qëndrimi ndaj sjelljes jo korrekte të kolegëve.  
Në rast se mjeku stomatolog vihet në dijeni të një sjellje të padenjë të një kolegu, e cila nuk përputhet me normat e etikës mjekësore, ai e ka për detyrë t'ja vërë në dukje këtë vetëm kolegut të tij dhe autoriteteve drejtuese të institucionit dhe/ose Urdhrit të Stomatologut. Atij nuk i lejohet të diskutojë për këtë me të sëmurët, me familjarët apo me kolegë dhe persona të tjerë.

- Neni 66 Detyrim për respektimin e Kodit.  
Eshtë detyrë e të gjithë mjekëve, e studentëve të mjekësisë që asistojnë apo zëvendësojnë mjekët në detyrë, si edhe e mjekëve praktikantë të njohin dhe të zbatojnë dispozitat e këtij Kodi gjatë gjithë karrierës profesionale. Mosnjohja nuk e përjashton asnjërin nga përgjegjësia dhe masat ndëshkimore për çdo kundravajtje të kryer.
  - Neni 67 Masat disiplinore  
Çdo akt mjekësor, apo sjellje profesionale në kundravajtje me dispozitat e këtij Kodi, përbën objekt për ndjekje dhe gjykim disiplinor profesional bazuar në Ligjin 127/2014, datë 02.10.2014 "Për Urdhrin e Stomatologut në Republikën e Shqipërisë" dhe në Rregulloren e Gjyimit Disiplinor Profesional të Urdhrit të Stomatologut.
  - Neni 68 Njoftimi i Urdhërit të Stomatologut për shkeljet  
Çdo mjek stomatolog e ka për detyrë të njoftojë Këshillin Rajonal përkatës të Urdhrit të Stomatologut për të gjitha shkeljet, të cilat në gjykimin dhe vlerësimin e tij janë në kundravajtje me dispozitat e këtij Kodi.
- Ne kete kuader, specialistet e sektorit tone I jepin pergjigje ligjore rreth "padijes juridike" dhe detyrimin qe ka mjeku per te njohur legjislacionet profesionale. Gjithashtu mjeku e ka per detyrim te denocoje dhe te njoftoje instancat tona per shkeljet qe mendon se jane kryer.

- **Ne vazhdimesi paraqesim mbeshtetjen ligjore dhe argumentimin perkates per ato cka ne kerkojme si sektor ndaj stomatologeve.**
- Neni 9 – Ndhima në raste urgjente  
Në prezencë të një të sëmurit apo të dëmtuari në rrezik për jetën, ose kur i bëhet thirrje për një rast të tillë, **mjeku stomatolog, pavarësisht profilit profesional, e ka për detyrë të ndërhyjë** në çdo vend e rrethanë **për të dhënë ndihmën urgjente**, duke asistuar deri në momentin që të sigurohet se ai po merr ndihmën mjekësore të kualifikuar.  
**Me kete nen dhe per zbatimin e ketij ne mbeshtetemi per te kerkuar canten e urgjences.**
- Neni 34 Dokumentimi i veprimeve mjekësore  
**Të gjitha veprimet** diagnostikuese e mjekuese që kryen në praktikën klinike **në çdo llojë shërbimi dhe profili** ambulator, spitalor, publik a privat, **mjeku përshkruan (regjistron) dokumentat mjekësore të posaçme të cilat ruhen** e mirëmbahen në përputhje me dispozitat që aplikon institucioni shëndetësor në kushtet e respektimit dhe të ruajtjes së sekretit profesional. **Mjeku stomatolog e ka për detyrë të krijojë Dosjen (kartelën) klinike individuale të të sëmurit**, e cila plotësohet dhe ruhet ndënjë përgjegjësinë e mjekut kurues si një dokument i rëndësishëm klinik, studimor-shkencor dhe juridik (mjeko-ligjor). Ai e ka për detyrë të përshkruaj në kartelën klinike qartë e kuptueshëm diagnozat, ekzaminimet dhe interpretimet e tyre, mjekimet dhe argumentat për çdo ndryshim që bën, si dhe konsultat mjekësore që kryhen për të sëmurin e tij.  
**Me kete nen dhe per zbatimin e ketij ne mbeshtetemi per te kerkuar regjistrin e pacienteve si dhe kartelen mjekesore.**

- Neni 35 Lëshimi i dokumentave mjekësore  
Në praktikën mjekësore është e domosdoshme bërja e dokumentave mjekësore, certifikata, epikriza, dëshmi, etj dhe lëshimi i tyre me kërkesë të të sëmurit, familjarëve ose organeve kompetente të njohura me Ligj. **Çdo dokument që plotëson dhe lëshon mjeku stomatolog duhet të hartohet në mënyrë korrekte**, plotësisht në përputhje me konstatimet mjekësore, të jetë i lexueshëm, ku të mund të identifikohet nënshkruesi dhe firma e tij.  
**Me kete nen dhe per zbatimin e ketij ne mbeshtetemi per te kerkuar vulen.**
- Neni 57 Sigurimi i mjedisit të punës  
Vendi ku mjeku stomatolog është instaluar për të ushtruar profesionin duhet të ketë mjedis të përshtatshëm pune, pajisje mjekësore dhe teknike, të cilat i përgjigjen dhe i përshtaten natyrës së akteve mjekësore parandaluese, diagnostikuese dhe terapeutike që ai praktikon. **Mjeku stomatolog nuk duhet të ushtrojë profesionin në kushte e rrethana që komprometojnë sigurinë e të sëmurëve dhe cilësinë e kujdesit ndaj tyre dhe publikut.**  
**Me kete nen dhe per zbatimin e ketij ne mbeshtetemi per te kerkuar:**  
**1)unit cilesor dhe funksional, 2)autoklaven dhe 3)setin e sterilizim-dezinfektimi, 4)nese preparatet de medikamentet jane brenda afatit te skadences, 5)mbeturinat spitalore, 6)certifikimin e perdorimit te radiografise.** Ne mbeshtetje te ketij neni dhe per ta kuptuar me mire ate, duhet ti referohemi ligjit 9928 per sherbimin stomatologjik si dhe rregulloren e sherbimt stomatologjik (urdhernr.580 dt.16.11.2012 nga min. V.Tavo).

- Neni 59 Mjekësia si biznes, publiciteti, ortakëritë
  1. Mjekut stomatolog nuk i lejohet të hyjë dhe të veprojë në ortakëri me farmacistë, stafet ndihmuese apo persona të tjerë për qëllime fitimprurëse të paligjshme.
  2. Mjekut stomatolog nuk i lejohet të praktikojë mjekësinë si biznes. Ai e ka kategorikisht të ndaluar të bëjë vizita apo konsultime në lokale e mjedise tregtare ku tregtohen medikamente, produkte, aparatura a pajisje të tjera mjekësore.
  3. **Është e ndaluar për mjekun të merret me reklamë a publicitet të çfarëdo lloji, me përjashtim të rasteve kur këto kanë qëllim shkencor apo edukativ.** Në këtë rast, mjeku duhet të bëjë kujdes që publiciteti të jetë objektiv dhe në përshatje me rregullat e deontologjisë mjekësore. **Mjekut nuk i lejohet të bëjë asnjë publicitet në favor të aktivitetit të tij personal apo të një institucioni të caktuar.** **Me kete nen dhe per zbatimin e ketij ne mbeshtetemi per te kerkuar [heqjen e publicitetit radioteleviziv.](#)**
- Neni 60 Treguesit profesional personal
  1. Të vetmit tregues që i lejohet mjekut të paraqesë në fletë recetat, dokumentat dhe njoftimet e ndryshme që publikon janë: - Emër, mbiemër, adresë, numër telefoni dhe orët e konsultave. - Titujt profesionalë legal (zyrtarë) të liçensuar dhe autorizuar nga Urdhri i Mjekëve për të ushtruar. - Titujt honorifik të njohura nga Republika e Shqipërisë.
  2. Treguesit që i lejohen mjekut të figurojnë në hyrje të kabinetit të tij janë: - Emri dhe mbiemri i tij. - Orari i konsultave. - Titujt profesional legal (zyrtarë) të liçensuar dhe autorizuar nga Urdhri i Mjekëve për të ushtruar. Kur mjeku stomatolog është titullar i një diplome të huaj, atëhere duhet të specifikohet vendi dhe Universiteti që ka lëshuar diplomën ose certifikatën që e autorizon të ushtrorë këtë profesion. **Me kete nen dhe per zbatimin e ketij ne mbeshtetemi per te kerkuar [heqjen e publicitetit apo tabelen e klinikes dentare me te dhena jo te perligjura.](#)**

- Neni 61 Kontrata e punës ( te neni 63 shprehet per poliklinikat)
 

**Ushtrimi i mjekësisë, në çdo formë** qoftë, pranë një institucioni privat a publik, **është i detyruar të bëhet në bazë të një kontrate me shkrim**, ku përcaktohen detyrimet dhe të drejtat përkatëse të palëve. Çdo projekt kontrate i komunikohet paraprakisht Këshillit Rajonal të Urdhërit të Mjekëve Stomatolog, i cili shpreh me shkrim vërejtjet dhe sugjerimet që mund të ketë. **Me kete nen ne mbeshtetemi per te kerkuar [kontraten/tat e punes.](#)**
- Neni 65 Mjeku stomatolog dhe institucionet e ndryshme (përgjithësim)
 

**Pavarësisht profilit apo institucionit në të cilin punon një mjek, publik apo privat, detyrimi i tij për respektimin dhe zbatimin e dispozitave të këtij kodi në ushtrimin e profesionit mbetet i pandryshuar.**

  1. Ushtrimi i profesionit i çfarëdo profili e në çdo institucion qoftë, publik a privat, është personal dhe i pavarur. **Mjeku stomatolog është përgjegjës për vendimet dhe aktet mjekësore që kryen.**
  2. Në çdo institucion publik apo privat, **ushtrimi i profesionit duhet të jetë objekt i një kontrate të shkruar, e cila të jetë në përshatje me dispozitat e këtij Kodi dhe me natyrën e specifikat e institucionit përkatës. Një mjek nuk duhet të nënshkruajë kontratë dhe të pranojë të punojë për një institucion i cili e privon atë nga mundësitë për të përmbushur detyrimet e tij etike dhe deontologjike mjekësore.**
  3. Pavarësisht institucionit në të cilin punon një mjek, publik apo privat, ai është i detyruar që përtej principeve dhe **rregullave** që parashikohen në dispozitat e këtij Kodi, të njohë ligjet, normat dhe rregullat administrative shtetërore dhe të institucionit ku punon, të cilat i përkasin fushës së ushtrimit të mjekësisë, detyrave dhe të drejtave të mjekut në profesion.



- Neni 65 Mjeku stomatolog dhe institucionet e ndryshme (përgjithësim) vazhdim
  4. Pavarësisht institucionit shëndetësor publik a privat në të cilin punon një mjek, ai e ka për detyrë t'i përgjigjet çdo kërkesë zyrtare për t'u vënë në dispozicion dhe bashkëpunuar kur bëhen hetime apo kërkohen informacione të ndryshme lidhur me të sëmurin e tij apo çfarëdo çështje tjetër. Ai duhet të ndihmojë autoritetet e interesuara, të cilat detyrimisht duhet të jenë të përligjura zyrtarisht, duke iu përmbajtur dispozitave të këtij Kodi për respektimin dhe ruajtjen e sekretit profesional. **Ketu mbeshetemi per te na informuar dhe bashkebiseduar per ushtrimin e profesionit te mjekut qe ne kontrollojme.**
  5. Është normë themelore e etikës mjekësore për çdo mjek stomatolog që, pavarësisht institucionit ku punon, të respektojë të drejtën e të sëmurit për të zgjedhur mjekun e tij dhe kur rrethanat e bëjnë të mundur, për ta patur këtë mjek prezent në çdo procedurë mjekësore të cilës i nënshtrohet ky i sëmurë.
  6. Pavarësisht profilit profesional dhe institucionit ku ushtron mjeku, në asnjë rast nuk duhet të pranojë të shpjet, bazuar në rendimentin e arritur në njësi kohe apo çdo kusht tjetër i cili do të kufizonte lirinë e tij për vendimmarrje klinike të pavarur dhe do të cënonte cilësinë e kujdesit shëndetësor.
  7. **Mjekut stomatolog nuk i lejohet përdorimi i publicitetit profesional personal apo në favor të institucionit publik apo privat në të cilin punon. Ai duhet të jetë i kujdesshëm për të mos lejuar përdorimin e emrit të tij nga institucioni në të cilin punon për qëllime publicitare.**
  8. Pavarësisht institucionit publik apo privat në të cilin punon, si dhe pozicionit hiarkik apo social të cilit i përket, **mjeku është i detyruar t'i përgjigjet çdo kërkesë nga Urdhri Stomatolog, për tu paraqitur për një proces gjykimi disiplinor profesional apo çfarëdo informacioni a bashkëpunimi që i kërkohet nga ky organizëm. Ketu mbeshetemi per te na informuar dhe bashkebiseduar no formen e bashkepunimit.**

## Rregulloren e praktikës profesionale (vendim KK nr 24, dt.02.11.2015)

- **Neni 1 Përkufizime**  
Në kuptimin e kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:
  - a) **Praktikë profesionale** – është ushtrimi i profesionit nga ana e praktikantit për një periudhë të caktuar nën udhëheqjen dhe përgjegjësinë e një profesionisti të kualifikuar dhe me përvojë, me qëllim për të fituar titullin profesional dhe aftësuar për ta ushtruar atë si i pavarur.
  - b) **Praktikant/Kandidat** – profesionisti i cili gëzon një dokument zyrtar të formimit profesional, apo kualifikimit profesional dhe që kandidon për të ushtruar praktikën profesionale dhe fituar titullin e një profesioni të rregulluar.
  - f) **Institucion Shëndetësor** - konsiderohet spitali, poliklinika, qendra shëndetësore, klinika dentare, ku praktikanti ushtron praktikën profesionale stomatologjike, në përputhje me programin dhe profilin e tij.
- **Neni 2 Parime të përgjithshme**
  1. **Bazuar në Ligjin Nr. 10171, datë 22.10.2009 "Për Profesionet e Rregulluara në Republikën e Shqipërisë", kandidati që zotëron një (DIPLOM) dokument zyrtar, i cili vërteton përfundimin e studimeve të larta, për të fituar titullin e tij profesional dhe të drejtën për të ushtruar profesionin si i pavarur, është i detyruar t'i nënshtrohet praktikës profesionale, për një periudhë të caktuar kohe.**
  2. Praktikës profesionale për një periudhë kohe të caktuar i nënshtrohet edhe profesionisti i cili kërkon t'i kthehet profesionit pas një shkëputje prej më shumë se 5 (pesë) vitesh.
  3. Për të filluar praktikën profesionale, çdo kandidat është i detyruar të paraqitet në zyrën qendrore të USSH për t'i bërë regjistrimin provizor dhe pajisur me dokumentacionin e nevojshëm.

SEKTORI  
INSPEKTIM-MONITORIMIT  
USSH

BAZA LIGJORE E FUNKSIONIMIT TE  
KETIJ SEKTORI

- Ky sector eshte ngritu me Vendim te Keshillit Kombetar te USSH me date 18.01.2016 me Nr.Vendimi 02.
- Ky vendim eshte I mbeshtetur ne ligjin 127/2014 dhe gjen perkrahje nga nenet 1-7, me konkret eshte neni 4/2.b I cili thote "vendos standarte etike dhe deontologjike, te detyrueshme per cdo stomatolog dhe monitoron zbatimin e tyre gjate ushtrimit te profesionit"; si dhe neni 7.2. "Urdhri i Stomatologut bashkëpunon me Inspektoratin Shtetëror Shëndetësor për kontrollin e zbatimit të këtij ligji dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fushën e shëndetësisë".